



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 19.4.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Baki Gimolli-ANJF, Ramadan Gashi-ANJF, Shefki Kastrati-NDI, Petrit Prenaj-TRIBUNA, Driton Vitia- Kosova Sot, Agnesa Haxhiu-KDI, Alma Tafarshiku-Eulex, Lekë Batalli-GLPS, Sanije Berisha-OSCE, Osman Shatri-Handikos, Rustem Gashi-Handikos, Amire Qamili-Birn, Norë Shabani-Koha Ditore, Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova, Dona Musa-RTK dhe Dibran Istrefi-Klan Kosova.

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24 dhe 29 mars 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L- 044, për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit me rrethinë.
8. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja, propozoi që në rendin e ditës të përfshihet edhe shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin 05/L-10, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

Kryesuesja, njoftoi Komisionin në lidhje me shkeljen e Ligjit dhe të Kushtetutës nga ana e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Dragan Veljoviq, i cili ishte po ashtu kandidat në listën zgjedhore për zgjedhjet në Serbi. Ajo theksoi se Dragan Veljković, sipas njoftimit nga Këshilli Gjyqësor, ka dhënë dorëheqje, dhe se Komisioni është në pritje të konfirmimit me shkrim nga Këshilli Gjyqësor, që pastaj të procedohet më tutje për përzgjedhjen e anëtarit të ri.

2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24 dhe 29 mars 2016;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 24 dhe 29 mars 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2015;

Kryesuesja, paraqiti një përmbledhje të përgjithësuar për raportin vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015, e me theks të veçantë përmendi faktin e 1.008 shërbimeve më pak gjatë vitit 2015, krahasuar me vitin 2014.

Kryesuesja Selvije Halimi kërkoi sqarim për pjesën se si erdhi deri te konstatimi se Agjencia ka 1.008 shërbime më pak, nëse kjo është si rezultat i mungesës së buxhetit apo rënies së kërkesave të qytetareve.

Baki Gimolli, rreth shqetësimeve të kryesueses, tha se dy shtyllat kryesore të këtij raporti, janë pjesa organizative funksionale dhe dispozitat materiale-funksionale, mbi bazën e së cilës realizohen edhe kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Gimolli theksoi se baza juridike e funksionalizimit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni që flet qartë se ndihma juridike falas u mundësohet të gjithë qytetarëve të Republikës, të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Në vazhdim, Baki Gimolli sqaroi se kjo agjenci ofron ndihmë juridike në katër fusha kryesore: në fushën penale, civile, administrative dhe në fushën e kundërvajtjes. Ai bëri të ditur se kjo

Agjenci shtrihet në pesë regjione të Kosovës dhe synim i Agjencisë është, që degët e veta ti ketë edhe në regionin e Ferizajt dhe atë të Gjakovës. Ndërsa, sa i përket mjeteve financiare, në bazë të llogaritjeve që janë bërë, për funksionalizimin e një zyre që ofron ndihme juridike falas, Gimolli tha se duhen 24.000 euro (njëzetekatër mijë euro), gjë që për dy zyra, duhen dyzetetë mijë euro.

Sipas Gimollit, pamundësia e futjes në funksion të këtyre dy zyrave regjionale, po e minon garantimin e saj, që sigurohet meqë kjo ndihmë ti ofrohet të gjithë qytetarëve, në tërë territorin e vendit.

Gimolli, gjithashtu njoftoi se një element tjetër që është bërë përpjekje nga agjencia, ka qenë bartja e të gjitha zyrave regjionale në institucione publike, në mënyrë që të kursehen edhe implikimet buxhetore.

Ai kërkoi nga Kuvendi, mbështetje financiare, për funksionalizimin e dy zyrave që u çekën më lartë.

Ramadan Gashi, në pyetjen e parashtruar nga deputetja Selvije Halimi, tha se mbyllja e dy zyrave, në Gjakovë dhe në Ferizaj, është arsyeja pse Agjencia ka më pak veprime në vitin 2015. Gashi sqaroi me shifra veprimet ndër vite të Agjencisë për Ndhim Juridike Falas. Ai tha para deputetëve se ndihma e kërkuar financiare nga donatorët, më nuk ekziston dhe se tashmë kjo ndihmë do të ofrohet vetëm si mbështetje, ku hyjnë trajnimet, avancimi i stafit dhe forma të tjera.

Kryesuesja, theksoi se Komisioni do ta procedojë në Kuvend rekomandimin dhe në kuadër të këtij rekomandimi, do të bëhet edhe kërkesa për financa shtesë. Në lidhje me Ligjin, ajo pyeti përfaqësuesit e Agjencisë për Ndhim Juridike Falas, nëse ka nevojë për plotësim dhe ndryshim?

Armend Zemaj, tha se dihet që ndihma juridike falas është e caktuar t'iu ofrohet atyre njerëzve, që nuk kanë mundësi materiale dhe gjithashtu shtoi se agjencia pothuajse e ka arritur qëllimin për të cilin edhe është themeluar.

Z. Zemaj theksoi se me një angazhim të përbashkët dhe me një hartim të një strategjie, edhe nga ana e agjencisë, mund të ketë një rregullim buxhetor dhe një rritje të kapaciteteve të brendshme, që t'iu ofrohet ndihmë qytetarëve. Ai tha, se me një riorganizim të buxhetit për vitin 2016 dhe 2017, gjithashtu duhet rishikuar vizitat jashtë vendit, kur dihet se janë zgjedhur njerëz të cilët janë mjaft të përgatitur për atë pozite, prandaj nuk ka nevojë të udhëtojnë jashtë vendit, përveç kontakteve, të cilat mund ta rrisin efikasitetin e agjencisë, thekoi Zemaj.

Agim Aliu, tha se një kursim sado i vogël i institucioneve të Kosovës, do të mund të sigurohej një shumë, e cila do të ndihmonte këtë agjenci. Ai tha, se qytetarët janë vetëdijesuar për kërkimin e të drejtave të tyre, por se kjo po i pamundësohet me mbylljen e dy zyrave të çekura më lartë. Duke ditur se kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë, ai potencoi se kjo e drejtë nuk po përmbushet nga ana e Kuvendit dhe e Qeverisë së Kosovës.

Institucioni duhet të ketë seriozitet dhe qëndrueshmëri buxhetore, që të mund të mbështetet agjencia dhe të gjitha organizatat, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët.

Ne fund, Aliu tha se raporti është i pranueshëm dhe rekomandimet që u propozuan, të dërgohen në mbledhje plenare dhe të miratohen.

Agim Ademaj, tha se raporti është i punuar mirë por, brengos mosfunksionimi i dy zyrave regjionale, e pastaj shtrohet pyetja, se a kanë të drejtë palët e një regjioni të kërkojnë ndihmë në

një region tjetër, mbase duhet të kenë të drejtë sepse regionet nuk janë kategori kushtetuese, edhe pse janë pranuar si të tilla.

Sa i përket ndihmës juridike primare, ku përfshihen njerëzit me asistencë sociale, Ademaj pyeti se cila është ajo masë e cila është e ngjashme me këtë kategori, e cila kërkon ndihme juridike falas? Ndërsa, për formën mobile, Ademaj, tha se është folur pak në këtë raport dhe ajo çka duhet të dihet është se a është funksionale dhe çfarë rezultate ka dhënë deri tash?

Ndërsa te pjesa tabelore, kërkoi sqarim se pse numri i lëndëve të pazgjidhura është kaq i madh? Ademaj tha se do të punohet që të sigurojmë buxhet, në mënyrë që dy zyrat, të cilat janë të mbyllura, të bëhen funksionale.

Danush Ademi, në pjesën ku flitet për komunitetet, ku thuhet: të përcaktohen komunitetet, pyeti se për çka bëhet fjalë?

Ramadan Gashi, tha se numri i lëndëve, sqaron numrin e angazhimeve juridike, që janë 3.851, prej tyre, 221 janë angazhime të avokatëve, ndërsa të tjerat janë veprime që kryhen nga zyrtarët për ndihmë juridike. Gjithashtu, ai potencoi se botëkuptimi që ka ekzistuar se rastet që i trajton Agjencia nëpër gjykata, nuk shqyrtohen si duhet, doli të mos jetë e vërtetë sepse rreth 90% të rasteve përfundohen me sukses.

Gashi shpjegoi se primare janë rastet me asistencë sociale, pensionistët, ndërsa sekondare janë rastet kur personat janë të punësuar, por që paga e tyre është me e vogël se mesatarja në Kosovë.

Baki Gimolli, tha se sa i përket pyetjes nëse Ligji për Ndihmë Juridike Falas, ka nevojë për ndryshim dhe plotësim, Projektligji është paraparë në planin e punës së Qeverisë për Ministrinë e Drejtësisë, ku do të bëhet një analizë, dhe mbi bazën e asaj analize do të konstatohet se a ka nevojë për ndonjë ndërhyrje.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet raporti vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2015;

4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës;

Kryesuesja, tha se me qëllim që të kompletohet Këshilli Prokurorial me anëtarë dhe meqenëse nuk kanë ardhur propozimet nga Këshilli për përfaqësuesin e Odës së Avokateve dhe nga Shoqëria civile, kemi vendosur që të mos shtyhet më kjo çështje. Ajo më tej njoftoi anëtarët e Komisionit se nga Fakulteti Juridik, kanë arritur tri propozime, ndërsa nga kolegji "Fama" është një propozim. Ajo theksoi se në këtë pikë ligji sqaron se kërkohen përfaqësues nga Universiteti, ndërsa të gjitha institucionet e tjera private, sipas ligjit për arsimin e lartë, nuk e kanë të drejtën të quhen universitete, por njihen si kolegje. Prandaj me qëllim që të mos bëhet shkelje e ligjit në këtë pikë, Komisioni kufizohet në kandidaturat të cilat vijnë nga Universiteti i Prishtinës, theksoi znj. Halimi.

NezirÇoçaj, duke u ndërlidhur me parafolësen,tha:meqenëse edhe universiteti edhe kolegji ofrojnë shërbime të njëjta edhe pse definohet qartë në ligj se kërkohen propozime nga universiteti, z. Çoçaj potencoi se nuk është mirë që t'i merret kjo e drejtë askujt.

Armend Zemaj, tha sesa i përket asaj se kandidatët vijnë nga universitetet ose nga kolegjet nuk mendoj se duhet bërë dallim, por duhet shikuar CV-ja e kandidatëve, për faktin se njeri nga kandidatët e ka arritur moshën e pensionimit, dhe sidomos duhet të kihet kujdes që këta kandidatë të mos jenë në lidhje politike, theksoi z. Zemaj.

Ai gjithashtu si një të arritur të madhe të Komisionit përmendi edhe faktin se është arritur që të bëhet një normimi ri në Republikën e Kosovës, që mandatet të jenë funksionale, mandatore dhe askush mos ta shohë veten të përjetshëm në një pozitë të sistemit të drejtësisë.

Agim Aliu, tha se është mirë të dërgohen katër propozimet në Kuvend që të mos bëhen dallime sepse është vota e deputetit ajo që vendos në fund. Ndërsa, sa i përket prapavijës politike, të gjithë kandidatët pak a shumë kanë pak prapavijë politike, por me rëndësi është që në momentin që zgjidhen të ushtrojnë detyrën në kuadër të një organi, i cili është shumë i rëndësishëm në sistemin e drejtësisë.

Agim Ademaj, në fjalën e tij tha se Kuvendit duhet t'i dërgohen tre kandidatë dhe propozoi që të shkohet me tre kandidatët nga Universiteti i Prishtinës.

Pas diskutimeve, Komisioni, duke u bazuar në nenin 3.2, të Ligjit nr. 05/L-035, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pasi shqyrtoi propozimet e fakulteteve juridike për emërimin anëtarëve në Këshillin Prokurorial të Kosovës, vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si në vijim:

- I. Për pozitën e anëtarit nga Fakultetet Juridike, propozohen:
 1. Rexhep Gashi,
 2. Azem Hajdari,
 3. Xhevdet Halili,
- II. Kuvendi prej 3 (tre) kandidatëve të propozuar, për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, do të zgjedhë njërin nga kandidatët e propozuar;
- III. Votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, bëhet me votim të fshehtë;
- IV. Mandati i anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është 5 (pesë) vjet.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe konstatoi se Projektligji i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë;

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 05/L-067, për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe tetraplegjikë;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 05/L-067, për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk pati vërtetje, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 05/L- 044, për Zonën e Rrezikuar mjedisore të Obiliqit me rrethinë;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 05/L-044, për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit me rrethinë, dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk pati vërtetje, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit me rrethinë dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme.

Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin 05/L-10, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe një abstenim, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
- III. Në aneks të procesverbalit janë paraqitur amendamentet e miratuara nga Komisioni.

Mbledhja përfundojë në orën 11:10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.
Mirlinda Kolgeci

Nënkryetarja e Komisionit,
Selvi Halimi

Aneks - Amendamentet në Projektligjin nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Amendamenti 1

Neni 6 paragrafi 5 i Projektligjit në rreshtin e parë fjalët “*mund të*” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 2

Neni 7 paragrafi 1 i Projektligjit në rreshtin e katërt fjalët “ sipas propozimeve” zëvendësohen me “pas propozimit” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Neni 7 paragrafi 3 i Projektligjit fjalët “të këtyre pozitave” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 11 paragrafi 1 i Projektligjit në rreshtin e gjashtë pas fjalës “*përpjekje*” **hiqen** fjalët “*të arsyeshme*” dhe më pas shtohen fjalët “ të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 4

Neni 13 paragrafi 4 i Projektligjit në rreshtin e nëntë pas fjalës “*përpjekje* shtohen fjalët “ të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Neni 13 paragrafi 5 i Projektligjit në rreshtin e katërt pas fjalës “*përpjekje*” hiqen fjalët “*të arsyeshme*” dhe më pas shtohen fjalët “ të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 5

Neni 30 i Projektligjit në rreshtin e dytë fjalët “mund të” hiqen, kurse pas fjalëve “90 ditëve” shtohen fjalët “ *nga hyrja në fuqi e këtij ligji*”.